

**FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT**

Data: 15.10.2015

Për: **Shoqërinë “Alb Garden” sh.p.k me NIPT K37513520N**

Proçedura e prokurimit: **“Proçedure e Hapur” me objekt “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohëshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Loti 2”**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe vendqëndrimeve të përkohëshme, segmenti rrugor Lushnje-Berat, Loti 2”**

Kohëzgjatja: **Periudha e zbatimit të projektit do të jetë 4 muaj, periudha e mirëmbajtjes 18 muaj**

Fondi limit: **56,322,935 (pesëdhjetë e gjashtë milion e treqind e njëzet e dymijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë) Lekë (pa TVSH)**

Burimi i financimit: **Buxheti i Shtetit**

Data e zhvillimit të proçedurës së prokurimit: **Date 26.08.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): **Nuk ka patur.**

Njoftojmë se kanë marrë pjesë në këtë proçedurë:

Nr	Operatori Ekonomik	Oferta (pa TVSH)
1	ELKRI & CO	42,241,879
2	KAMPING PA EMER PEPOSHI KARPEN - KAVAJE	52,375,846
3	ALB GARDEN	52,560,518
4	FUSHA & GREEN FARM	53,687,440
5	KAJMAKU	Nuk ka paraqitur ofertë

Jane skualifikuar operatorët e mëposhtëm ekonomike me arsyt përkatëse:

“Elkri” sh.p.k, për arsye se:

Nuk plotëson kërkesën për realizimin e punëve të ngjashme, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion për realizimin e punimeve të gjelbërimit. Puna e paraqitur me

objekt “Rikonstruksioni i qendrës Markat” nuk ka asnjë gjë të përbashket me objektin që prokurohet.

Nuk plotëson kërkesën për disponimin e makinerive pasi nuk ka asnjë kamion me peshëmbajtje mbi 20 ton (për kamionet me targë SR 73 30 B dhe AA 341 AT nuk është paraqitur leja e qarkullimit, ndërsa kamionët e tjerë janë me peshëmbajtje me të vogël se 20 ton). Mungon makineria e hidrombjelljes, pasi mjeti i paraqitur është një frezë të thjeshtë për frezimin e tokës.

Nuk plotëson kërkesën 3.4 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 39001 për menaxhimin e sigurisë rrugore (Road Traffic Safety Management), lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

“Kamping pa emër Peposhi Karpen Kavaje” sh.p.k, dhe “Bruschi” srl për arsye se:

Marrëveshja e bashkëpunimit nuk është hartuar në përputhje me ligjin, pasi mungon ndarja konkrete e punëve. Kjo gjë bën të pamundur gjykimin e mëtejshëm për plotësimin e kërkesave për kualifikim veçmas për secilën shoqëri.

Bashkimi i shoqërive në formularin e ofertës nuk ka vendosur TVSH dhe çmimin me TVSH, duke devijuar nga dokumenti standart i dhënë me Dokumentet Standarte të Tenderit.

Bashkimi i shoqërive nuk plotëson kërkesën për disponimin e mjeteve, pasi autobotit me targë AA129GU i ka skaduar siguracioni që në datën 16.06.2015, ndërsa certifikata e kontrollit teknik në datën 17.06.2015, ka vetëm një kamionçinë 1 deri 1,5 ton nga dy të kërkuara (kamionçina me targë AA714II), ka një kamion mbi 20 ton (TR16 82 N) nga dy të kërkuar pasi mjeti me targë TR3659R ka peshëmbajtje me të vogël se 20 ton dhe siguracioni i ka skaduar në datën 22.05.2015; mjeti me targë AA097KO ka peshëmbajtje me të vogël se 20 ton. Mungon makineria për nivelim e kërkuar në kërkesat për kualifikim.

Shoqëria “Kamping pa emër Peposhi” nuk ka paraqitur Deklaratën e Gjëndjes Gjyqësore.

Shoqëria “Kamping pa emër Peposhi” nuk plotëson kërkesën 2.4.1 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (realizimin e punëve të ngjashme) pasi për punën e realizuar nuk ka paraqitur aktin e kolaudimit nga një kolaudator i licencuar. Gjithashtu tek Formulari i Vlerësimit për punën e ngjashme vlera e objektit është shënuar 157.168 pa shënuar nëse është Lekë apo monedhë tjetër.

Shoqëria “Bruschi” nuk plotëson kërkesën 2.1 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit pasi nuk ka paraqitur deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike sipas Shtojcës 5, deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës dhe deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 9.

Shoqëria “Bruschi” nuk plotëson kërkesën 2.4.1 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (realizimin e punëve të ngjashme) pasi për punën e realizuar ka paraqitur një fature tatimore me vlerë 156.870 Euro ose rreth 21.961.800 Lekë, ndërkohë që si anëtar i bashkimit të shoqërive me përqindjen më të madhe i takon të vërtetohet se ka realizuar pune me vlerë jo më pak se 28.250.000 Lekë (pa TVSH).

Shoqëria “Bruschi” nuk plotëson kërkesat 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.4 të Kërkesave të Veçanta të Kualifikimit (certifikatat ISO dhe OHSAS) pasi nuk i ka paraqitur këto certifikata.

Komisioni nuk është në gjendje të gjykojë për përmbushjen e kërkesve të tjera pasi verifikimi i tyre duhet të bëhet në raport me punët konkrete që ka marrë përsipër secila shoqëri, dhe kjo ndarje e detajuar mungon në marrëveshjen e bashkëpunimit.

I gjithë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Bruschi” është i pa apostiluar sipas kërkesave të ligjit.

“Kajmaku” sh.p.k, për arsye se nuk ka paraqitur ofertë.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **operatorin ekonomik “Alb Garden” sh.p.k, me NIPT K37513520N**, se oferta e paraqitur me vlerë **52,560,518 (pesëdhjetë e dy milion e pesëqind e gjashtëdhjetë mijë e pesëqind e tetëmbëdhjetë) Lekë (pa TVSH)** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë**
- **Phone: +355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: +355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **16.09.2015**.

Ankesa: Për vlerësimin paraqiti ankesë bashkimi i përkohshëm i shoqërive “Kamping pa emër Peposhi Karpen Kavajë” sh.p.k. dhe “Bruschi” srl në datën 21 Shtator 2015. Ankimit iu dha përgjigje në datën 25.09.2015 duke e refuzuar atë.